REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 343, Datë 06.11.2026
MBI

FILLIMIM E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E MODELIT TIP TË LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 18, 19 dhe 20, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; si dhe neneve 15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s* miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3501 prot., datë 05.11.2026, të përgatitur nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026 "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin modelit tip të Licencës për prodhimin e energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", është përcaktuar një kuadër i ri ligjor për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë veprimtarinë e prodhimit, si dhe për kompetencat e ERE-s në përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave.
- Neni 20, pika 1, gërma "b" i ligjit nr. 59/2026, i njeh ERE-s të drejtën për të përcaktuar rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndërsa dispozitat e ligjit që rregullojnë licencimin përcaktojnë bazën për vendosjen e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.
- Modeli tip ekzistues i licencës për prodhimin e energjisë elektrike është hartuar në bazë të kuadrit ligjor të mëparshëm dhe kërkon rishikim për t'u harmonizuar me kërkesat dhe terminologjinë e ligjit nr. 59/2026, si dhe me aktet nënligjore që miratohen në zbatim të tij.
- Rishikimi i modelit tip synon të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të njëtrajtshme objektin dhe kufijtë e veprimtarisë së licencuar, të drejtat dhe detyrimet e prodhuesit, kërkesat për operimin teknik, mirëmbajtjen, raportimin, ruajtjen e dokumentacionit, kontrollin dhe monitorimin nga ERE, si dhe trajtimin e ndryshimeve që mund të ndikojnë në kushtet e licencës.
- Projekt-modeli parashikon një strukturë të riorganizuar të dokumentacionit shoqërues, me Aneksin A për identifikimin e impianteve dhe njësive gjeneruese, Aneksin Teknik për pasqyrimin e parametrave teknikë dhe kushteve të lidhjes, si dhe Aneksin B për kushtet e posaçme që mund të vendosen për të licencuarin, kur kjo justifikohet dhe mbështetet në bazën ligjore përkatëse.
- Ky dokument merr në konsideratë edhe rastet e depozitimit të integruar me impiantin e prodhimit, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 59/2026, duke bërë dallimin ndërmjet njësive të integruara të depozitimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së pavarur të depozitimit, e cila i nënshtrohet kërkesave përkatëse të licencimit.
- Gjatë hartimit të projektt-modelit janë shqyrtuar gjithashtu praktika rregullatore ndërkombëtare, përfshirë kushtet standarde të licencave të prodhimit të Ofgem dhe praktikat e autoriteteve të tjera rregullatore, me qëllim përmirësimin e strukturës dhe qartësisë së kushteve të licencës.

- Projekt-modeli së bashku me Anekset, do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore, për të marrë komente dhe propozime përpara paraqitjes së tij për miratim përfundimtar nga bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e modelit tip të Licencës për prodhimin e energjisë elektrike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-modeli tip, së bashku me Aneksin A, Aneksin Teknik dhe Aneksin B, do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës, dhe përgatitjen e materialeve për vijimin e procedurës së miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI